



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME RROGOZHINE SH.A.
ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Nr. 9 Prot

Rrogozhine 8 / 05 / 2023

V E N D I M

Nr. 5 Datë 8 / 05 / 2023

**“ PËR MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TE AKTIVIETTIT DHE PRISHJES
TË SHOQËRISË UKRR SHA ”**

Asambleja e Aksionerëve me Vendim Qarkullues, referuar Marreveshjes Nënshkruar nga Administratorit të UKRR Rrogozhine sha dhe Administratorit të SHRUK Durrës sha, nënshkruar sipas autorizimeve të dhëna nga Asambleja e secilës shoqëri bazuar në VKM Nr 302 datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, vëren se shoqëria UKRR e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi, dhe nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar;

Në vijim pasi u shqyrtua bilanci i periudhës vjetore 2022 konkludohet se, shoqëria nuk disponon më asete. Të dhënat janë pasqyruar në Raportin e Transferimit të Ekspertit z. Sokol Toska të emëruar sipas VKM nr 302 datë 11.05.2022 për transferimin e aktivitetit nga SHRUKD. Aksionarët deklarojnë se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve do të shlyhen nga SHRUKD sha dhe janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit. Kjo është realizuar nëpërmjet transferimit të të gjitha detyrimeve në ngarkim të shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësijellës Kanalizime Durrës sha dhe kjo shoqëri është angazhuar të shlyejë detyrimet në rregullim normal të veprimtarive të saj. Gjithashtu, marrëdhëniet me punojësit janë rregulluar nëpërmjet transferimit të tyre në shoqërinë Rajonale Ujësijellës Kanalizime Durrës sha. Në konkluzion, shoqëria nuk zhvillon më aktivitet ekonomik dhe në këtë mënyrë mund të deklarohet prishja, çregjistrimi në përputhje me parashikimet e ligjit “Për shoqëritë tregtare” dhe shoqëria mund të çregjistrohet, pasi aktiviteti është transferuar.

Për sa më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të prishet dhe të çregjistrohet nga regjistri tregtar QKB, Drejtoria Tatimeve dhe cdo organ tjetër publik.

Adresa: Lagja Nr.1, Rruge e Stacionit te Trenit, blloku "12 Shtatori" Rrogozhine. Email: rrogozhineuk@yahoo.com

Bazuar ne Ligjin Nr 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; VKM Nr 302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" Vendimit të Këshillit Bashkia Rrogozhine Nr 45 dt 15.08.2022 "Për miratimin e Marrëveshjes për krijimin e Subjektit kopetenca të përbashkëta të Ujësjetllës kanalizime datë 28.06.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Bashkive Shijak, Krujë, Kavaje, Rrogozhinë";

Vendosi

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj.
2. Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese.
3. Emërimin e z.Kasem Bejko si Likuidator i shoqërisë.
4. Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në perputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Aksionarët

Bashkia Rrogozhine

Emer/Mbiemer

EDISON MEMOLLA

Firma

